



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorëzuar Prilidjen / Prudato Received / Delivery	01.03.2022	viti god year	2
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMBIK	1111/2022		112



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

**A.nr.33/2022**

**Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**, Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari- kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtar dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.33/2022 të datës 18.01.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi kundër organit të punësimit Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës në çështjen juridike "*kerkesë nga marrëdhënia e punës*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 01.03.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**SHPALLET jo kompetent** Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.33/2022 të datës 18.01.2022, të parashtruar nga ankuesi

**A r s y e t i m**

Ankuesi sipas Marrëveshjes për Shërbime të Veçanta me Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës të datës 30.06.2021 me numër të referencës DS-349/2021 i kryen detyrat për vendin e punës "Konsulent i përkohshëm Ligjor" në Gjykatën Themelore Gjilan Dega Kamenicë.

Ankuesi me datë 18.01.2022 ka parashtruar ankesë nëpërmjet e-mailit zyrtarë të Këshillit të Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër të protokollit 200/2022, me pretendim ankimor për kompensimin e diferencës së pagës gjatë kohës sa ka qenë në pushim mjekësor.

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 26.01.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës më datë 11.02.2022 ka përcjell dokumentacionin e kërkuar me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 18.01.2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; e-mail i datës 17.01.2022; Raportet mjekësore; Marrëveshja për Shërbime të Veçanta e datës 30.06.2021 me Nr.Ref.DS:349/2021 si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.





Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar përgjigjen në ankesë me numër protokolli 681/2022 të datës 11.02.2022 nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe dëshmime të ofruara nga ankuesi, në bazë të shqyrtimit të provave të lëndës, respektivisht Marrëveshjes për Shërbime të Veçanta e datës 30.06.2021 me Nr.Ref.DS:349/2021, ka konstatuar se ankuesi ketë marrëveshje e ka nënshkruar pas procedurave të rekrutimit për punësim të kontratës të quajtur "Marrëveshje për Shërbime të Veçanta", në pozitën punës "Konsulent i përkohshëm Ligjor" në Gjykatën Themelore Gjilan Dega Kamenicë, e cila marrëveshje është lidhur ndërmjet Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe „Projektit të Sistemit Qendror të Evidencës Penale” nga Zyra e Bashkimit Evropian, duke u bazuar në dispozitat e nenit 12 paragrafit 4 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Ligjin Nr.04/L-077 për Marrëdhënie të Detyrimeve, dhe duke aplikuar procedurën e thjeshtësuar e rekrutimit për punonjësit të cilët angazhohen me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtë se gjashtë (6) muaj me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta.

Me dispozitat e nenit 12 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar që: „Emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtë se gjashtë (6) muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura „Marrëveshje për shërbime të veçanta” të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit”.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar, se nuk është kompetent për shqyrtimin e kësaj ankese, pasi që ankuesi nuk e ka statusin e nëpunësit civil sepse marrëdhënien e tij të punës me Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës e ka themeluar në bazë të "Marrëveshjes për Shërbime të Veçanta", për të cilat marrëveshje nuk aplikohen dispozitat e ligjit për shërbimin civil rrjedhimisht Këshilli nuk ka kompetent për shqyrtimin e kësaj çështje.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se ankuesit fillon ti rrjedh afati për ankimim pas pranimit të këtij Vendimi, dhe se të drejtën e tij mund ta realizoj në pajtim me dispozitat e akteve ligjore dhe nënligjore, me të cilat rregullohet marrëdhënia e punës për kategoritë nëpunësve të administratës të cilët nuk i përkasin shërbimit civil, në pajtim me afatet e përcaktuara me Ligjin Nr. 03/L-212 të Punës.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.33/2022**

Valentina Kaçandolli Bekteshi

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

